

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
 REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
 Ministry of Local Government Administration

Nr. Br. 020-150/5
 No. 05-03. 2026
 Data. 05.03. 2026
 Datum. 05.03. 2026
 Date.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Valon Prebreza, Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës Vlonjat Hasani, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erblin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 27.02.2026 VI-020-150
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Fushë Kosovës	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren Nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 04/2026 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 73 për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

I miratuar më datë: 18.02.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 25.02.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Fushë Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 18.02.2026, ka miratuar Vendimin Nr. 73 për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Fushë Kosovës, është bazuar në nenin 11, nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja (d), nenin 40 paragrafi 40.2 shkronja (e), nenin 51 paragrafi 51.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13 paragrafët 1 dhe 3, nenet 14 dhe 15 të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, në nenin 27 shkronja (e), nenin 40 paragrafi 40.1 shkronja (dh) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, me të cilin vendim është themeluar Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës me datë 18.02.2026, dhe është miratuar me 26 vota për, 1 kundër dhe 0 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za :	Valon Prebreza, gradonačelnik opštine Kosovo Polje Vlonjat Hasani, predsedavajući Skupštine opštine Kosovo Polje	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a,	
Od:	Erbilin Hetemi, direktor Pravnog odeljenja u MALS-u	Dana, 27.02.2026. VI-020-150
Odgovorni službenici:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za razmatranje zakonitosti akata opštine i gradonačelnika Vjosa Ahmetaj, viša službenica za razmatranje zakonitosti akata opštine	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Kosovo Polje	
Vrsta odluke:	Odluka Skupštine opštine Kosovo Polje	

Poštovani gradonačelniče,

Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa članom 9 Zakona br. 08/L-284 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 04/2026, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 73 o osnivanju Odbora za zdravlje i blagostanje

Usvojena dana, 18.02.2026.

Podnešena na razmatranje u MALS-u dana, 25.02.2026.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština opštine Kosovo Polje, na sednici održanoj dana, 18.02.2026, je usvojila **Odluku br. 73 o osnivanju Odbora za zdravstvo i blagostanje.**

MALS, utvrđuje da je odluka koju je izdala Skupština opštine Kosovo Polje zasnovana na članu 11, članu 12 stav 12.2 tačka (d), članu 40 stav 40.2 tačka (e), članu 51 stav 51.2 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi („Službeni glasnik“ br. 28/2008), članu 13 stavovi 1 i 3, članovima 14 i 15 Administrativnog uputstva br. 05/2020 o postupcima za osnivanje, sastav i nadležnosti stalnih odbora i drugih odbora u opštini, na članu 27 tačka (e), članu 40 stav 40.1 tačka (dh) Statuta opštine br. 98 od 17.08.2012. godine, odlukom kojom je osnovan Odbor za zdravstvo i blagostanje.

Odluka je usvojena na sednici Skupštine opštine Kosovo Polje dana, 18.02.2026. godine, sa 26 glasova „za“, 0 „protiv“ i 0 „uzdržanih“.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.